



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA Durrës**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 30, datë 28.04.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NË VKB-NË NR.163, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SI DHE KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME SPORTIVE “BENARDINA QERAXHIA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESIVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.163, datë 23.12.2021 “Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar si dhe konviktit të Shkollës së Mesme Sportive “Benardina Qeraxhia”, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2021-2022” të ndryshuar, shkresës nr.19590 prot., datë 08.11.2021 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 12210 prot., datë 12.11.2021, shkresës nr.5204/61 prot., datë 24.11.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 11473/2 prot., datë 01.12.2021, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.571, datë 16.11.2021 “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2021-2022”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.572, datë 16.11.2021 “Për ngritjen e komisioneve pranë Shkollave të Mesme Teknologjike, Profesionale dhe Sportive të qytetit të Durrësit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2021-2022”, Shkresës së Drejtorisë së Shkollës 9 Vjeçare “Abedin Dino” datë 29.03.2022, protokolluar me tonën nr. 2831 prot., datë

30.03.2022, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.163, datë 23.12.2021 përsa i përket heqjen e bursës për nxënësen Rejhana Adem Hebeja, e përfshirë në tabelën e pikës 4 “Miratimin e listës emërore të nxënësve të institucioneve arsimore parauniversitare të Bashkisë Durrës, që përfitojnë bursë pasi plotësojnë kriterin ekonomik 2.1/c në zbatim të VKM-së nr.666/2019 të ndryshuar, për vitin shkollor 2021-2022”, nr.rendor 3, si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Klasa	Data e largimit
3	Rejhana Adem Hebeja	XII	7.02.2022

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 29.04.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 395 / prot.  
5

Durrës, më 06.05.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRE'S



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.30 datë 28.04.2022 “Për miratimin e ndryshimit në VKB nr 163 dt 23.12.2021 “Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar si dhe konviktit të shkollës së mesme sportive “Bernardina Qeraxhia” që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2021-2022” të ndryshuar.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
EMILJAN JANI

